



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Aurela Saliq
Të 20/8 Kërkimi i J.M.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE

ZYRA VENDORE E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR
FIER

Nr. Prot. 122/Vlorë, 22.04.2025

Nr. Prot. 98/Vlorë, 28.04.2025

MARREVESHJE BASHKEPUNIMI

NDERMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

DHE

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë, përfaqësuar nga **Rektore Prof. Dr. Aurela Saliq**, është një institucion publik, që ka statusin juridik, krijuar në pajtim me nenin 57, paragrafi 7 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe të ligjit 80/2015 «Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë»,

dhe

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier, përfaqësuar nga **znj. Miglena Sofroni Drejtor** institucion publik, që ka statusin juridik krijuar në pajtim me nenin 57 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

Nisur nga interesi i përbashkët për zhvillimin e praktikave mësimore, duke vlerësuar kontributin e deritanishëm si dhe me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin tonë palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "**Marrëveshja**")

Adresa /Adress: Bulevardi
Tel. Fax ++355222288

Vlore-Skelcëeb-site: eëë.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim, bashkëpunimin ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Fier në kuadër të zhvillimit të praktikës mësimore nga ana studentëve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, për plotësimin e studimeve universitare të tyre në nivelin "Bachelor" apo "Master", pranë shkollave në varësi të ZVAP Fier.

Neni 2
Baza ligjore

Zhvillimi i praktikës mësimore bazohet në ligjin 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjin Nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" ...dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Urdhërit Nr.31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", VKM – së Nr.77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor".

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo marrëveshje bashkëpunimi, zbatohet midis Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Fier për zhvillimin e praktikës mësimore për programet mësimore "Bachelor" apo "Master" gjatë vitit mësimor 2024 - 2025, për periudhën mars - qershor 2025.

Studentët e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, do ta zhvillojnë praktikën mësimore pranë shkollave në varësi të ZVAP Fier, sipas listës që do të përcillen nga Njësitë kryesore të Universitetit pranë ZVAP.

Neni 4
Detyrimet e palëve

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier, merr përsipër:

1. Lejimin e studentëve të UV-së, për të zhvilluar praktikën mësimore pranë shkollave të caktuara nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier.



2. Udhëzimin e drejtuesëve dhe mësuesve të institucioneve arsimore parauniversitare publike në lidhje me zhvillimin e praktikës mësimore të studentëve pranë këtyre shkollave.
3. Në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave, caktimin e një apo më shumë mësuesve (në varësi të numrit të studentëve) për orientimin, mbikqyrjen, mentorimin e studentëve gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore.
4. Në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave, raportimin pranë Universitetit të Vlorës mbi problematikat e ndryshme që mund të jenë krijuar nga ana e studentëve të hasura gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore, pranë institucioneve arsimore të ndryshme.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, merr përsipër:

1. Depozitimin, (para fillimit të praktikës mësimore), pranë çdo drejtorie të shkollave të përcaktuara nga ZAVP, listës emërore (me firmë dhe vulë nga Njësia bazë) të studentëve që do të zhvillojnë praktikën mësimore.
2. Depozitimin pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Fier të dokumentit justifikues ligjor në lidhje me derdhjen e kontributeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale të të gjithë studentëve që do të zhvillojnë praktikën mësimore për të gjithë periudhën e praktikës mësimore, në zbatim të VKM – së Nr.77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor".
3. Orientimin e studentëve në lidhje me respektimin e rregullores së shkollës, orarin e përcaktuar nga drejtuesit e shkollës, etj, me qëllim mos cënimin dhe mosprishjen e orës mësimore në këto institucione arsimore parauniversitare ku studentët janë caktuar për të kryer praktikën mësimore.

Palët kanë detyrimin të mbrojnë të dhënat personale që përpunohen dhe në mënyrë të veçantë për të dhënat sensitive, në përputhje me ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008, i ndryshuar "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 5

Zgjidhja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të zgjidhet duke pushuar cdo efekt të saj me njoftimin paraprak të palëve në rastet e mëposhtme :

1. Në rastin e mosdorëzimit të dokumentit justifikues ligjor në lidhje me derdhjen e kontributeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale të të gjithë studentëve që do të zhvillojnë praktikën mësimore për të gjithë periudhën e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

praktikës mësimore. Në rastin e mosrespektimit nga ana e Universitetit të Vlorës, të kushteve të tjera të përcaktuara në këtë marrëveshje.

2. Në rastin e mosrespektimit nga ana e Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier, të kushteve të tjera të përcaktuara në këtë marrëveshje edhe pas njoftimit nga ana e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Neni 6 Hyrja ne fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga 1 (një) kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe 1 (një) kopje do të depozitohet në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Fier.

PËR

UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTORE

PROF. DR. AURELA SALIAJ



PËR

ZYRA VENDORE E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR FIER

DREJTOR

ZNJ. MIGLENA SOFRONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Vlorë më, 30.04.2025

Për zbatim :

- DEKAN FAKULTETIT TË SHËNDETIT
Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli
- DEKAN FAKULTETIT TË EKONOMISË
Prof. Asoc. Zamira Sinaj
- DEKAN FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE ✓
Prof. Dr. Roland Zisi
- DEKAN I FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE ✓
Prof. Asoc. Miftar Ramosaçaj

REKTOR

Prof. Dr. Aurela SALIAJ

